



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

### A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, derisa z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi.

Nr.prot. 02-020/05-0000570/23  
Podujevë, datë: 04.01.2023



Kryetari i Komunës  
Shpejtm Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat b), g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. **z**, Alban Shabani, zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, **Autorizohet** edhe në kryerjen e punëve dhe detyrave nga pozita e zyrtarit të lartë të buxhetit dhe financave, përkatësisht për kryerjen e punëve dhe detyrave të nën-alokimeve.

2. I Autorizuari po ashtu lejohet për ndjekjen e trajnimeve dhe certifikimit nga fusha e punëve dhe detyrave të nën alokimit në kuadër të pozitës së zyrtarit të lartë për buxhet dhe financa.

#### Neni 2

Autorizimi i të përmendurit bëhet për shkak të shkuarjes në punë dhe detyra tjera të zyrtarit të lartë për buxhet dhe financa, si dhe vëllimit të shtuar të punëve dhe paraqitjes së nevojës që në kuadër të pozitës së cekur punët dhe detyrat të kryhen në mënyrë sa më efikase sa i përket shpenzimit të parasë publike dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë dhe ndërliken me pozitën e zyrtarit të lartë për buxhet dhe financa.

#### Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Personelit.

#### Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/05-0073423/22, datë 29.08.2022.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit të lartë për buxhet dhe financa, apo deri në një akti tjetër.

*U dërgohet:*

*Të caktuarit*

*DBF dhe Zyrës së Personelit*

*QSHQ/Arkivës*

Nr.prot. 02-020/02-0001119/23  
Podujevë, 25.01.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 parag 1.2 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë :

### V E N D I M

#### Neni 1

z. Valon Shabani, zyrtar për buxhet dhe financa 2, në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, **autorizohet** të nënshkruaj tërë dokumentacionin si dhe të kryej detyrat dhe përgjegjësitë nga pozita e zyrtarit certifikuesit, sipas rregullativës ligjore.

#### Neni 2

Autorizimi jepet për shkak të ngarkesave në ekzekutimin e pagesave.

#### Neni 3

Autorizimi vlen për periudhën të pacaktuar, përveç nëse me një akt tjetër vendoset ndryshe.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:

- DBF
- Zyrës së Personelit
- Të autorizuarit
- QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0002262/23  
Podujevë, datë: 06.01.2025





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronjat b) c) g) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafët 1.2; 1.3 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerrë këtë;

### V E N D I M

#### Neni 1

Për riorganizimin hapësirave / zyrave brenda ndërtesës së administratës komunale, përkatësisht risistemimin e shërbimeve dhe zyrtarëve në kuadër të hapësirave të ndërtesës, ngritët Grupi Punues në këtë përbërje:

- |  |           |
|--|-----------|
| 1. <b>Marigona Lahu</b> , Nënkryetare e Komunës,                     | kryesuese |
| 2. <b>Edona Çitaku</b> , shefe e kabinetit të Kryetarit të Komunës,  | anëtare   |
| 3. <b>Antoneta Ejupi</b> , drejtoresh e Drejtorisë së Administratës, | anëtare   |
| 4. <b>Fitim Bunjaku</b> , Menaxher i Personelit,                     | anëtar    |

#### Neni 2


Grupi punues sipas nenit 1 të këtij vendimi, bën vlerësimin e gjendjes aktuale të hapësirave / zyrave brenda ndërtesës së Komunës, si dhe riorganizimin dhe risistemimin e shërbimeve dhe zyrtarëve sipas nevojave dhe duke marrë për bazë funksionimin sa më efikas të administratës komunale, si dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë.

#### Neni 3


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Tu dërgohet;*  
Anëtarëve  
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0004155/23  
Podujevë, datë: 13.01.2023



**Kryetari i Komunës**  
**Shefitim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT/ES PËR KOORDINIMIN E KONSULTIMEVE DËGJIMEVE DHE TAKIMEVE PUBLIKE

##### Neni 1

**znj.Liridona Rrahmani**, zyrtare për informim dhe monitorim të mediave në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, krahas punëve dhe detyrave nga pozita sipas akt-emërimit, **caktohet** zyrtare për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Podujevës.

##### Neni 2

E përmendura, sipas këtij vendimi, bënë koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Podujevës konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

*E caktuara*

*Zyra e personelit*

*QSHQA/Arkiva,*

Nr.prot. 02-020/05-0004539/23  
Podujevë, datë: 16.01.2023





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 4 parag. 2.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

### **V E N D I M** **PËR EMËRIMIN E ZYRTARIT PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN**

#### **Neni 1**

**z.Gent Jetullahu**, nga Podujeva, me kualifikim Fakulteti Komunikim Masiv–Dega Produksion, emërohet;

- **Zyrtar për marrëdhënie me publikun në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës**

#### **Neni 2**

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të ndihmës teknike administrative dhe mbështetjes së Kryetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi.

Mandati i të emëruarit është në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

#### **Neni 3**

Paga mujore e të emëruarit caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

I dërgohet:  
Të emëruarit  
Zyrës së personelit  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0004865/23  
Podujevë, datë: 16.01.2023



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNES**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. prot.01-020.01-0050862/18, dhe nenin 27 paragrafin 1.3 të Rregullores nr. prot. 01-016/01-0030667/22 datë 29. 04. 2022 për kushtet kritere dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002690/22, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas kërkesës nr.09-615/03-0002703/2023 të datës 10.01.2023, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nxjerrë;

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

z. Liridon Lahu nga Podujeva, për organizimin e turnirit njëditor të futbollit të vogël, që ka për synim bashkimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mbështetët me mjete financiare në shumë prej 800 €.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë bankare të z.Liridon Lahu.

#### **Neni 3**

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.prot.** 02-400/04-0002690/23  
**Podujevë, datë,** 16.01.2023



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **NËNKRYETARJA E KOMUNËS**

Bazuar në nenin 60 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, neni 8 parag. 5.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenin 63 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

**z.Gent Jetullahu**, lirohet nga pozita Asistentit administrativ në Zyrën e Nënkyetares së Komunës së Podujevës.

#### **Neni 2**

Lirimi nga detyra e asistentit bëhet për shkak të riorganizimit të stafit politik në kuadër të Ekzekutivit të Komunës

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:  
Të përmendurit  
Zyrës së Personelit  
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-118/02-0004860/123  
Podujevë, datë: 16.01.2023

**Nënkyetarja e Komunës**  
**Marigona Lahu**







**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të përfaqësueses së projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2) datë 22 nëntor 2022, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

Formohet Ekipi Monitorues i Komunës së Podujevës për monitorimin dhe raportimin në kuadër të projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), në këtë përbërje:

Fitim Bunjaku, Menaxher i Personelit, koordinator

Liridona Rrahmani, zyrtare në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, zëvendës koordinatore

Xhevrie Beqiri, zyrtare në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare

Ardonis Jusufi, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, anëtar

#### Neni 2

Ekipi Monitorues ka për obligim të bëjë monitorimin e zbatimit të projekt propozimeve në bazë të kritereve të paraqitura sipas thirrjes publike në kuadër të projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2).

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohen vendimet e mëparshme lidhur me këtë çështje.

*U dërgohet:*

*Anëtarëve të Ekipit*

*Menaxheres së projektit*

*Zyrës së Personelit*

*QSHQ/Arkivës*


Nr.prot. 02-020/06-000919/23  
Podujevë, datë: 17.01.2023



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera 04/L-027, nenin 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerr,

### VENDIM PËR NGRITJEN E SHTABIT EMERGJENT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

#### Neni 1

Ngritët Shtabi Emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, për menaxhimin e krizave në nivel Komune, në këtë përbërje:

<b>Marigona Lahu</b> , <i>Nënkryetare e Komunës,</i>	Kryesuese
<b>Bahri Selimi</b> , <i>Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	Koordinator
<b>Antigona Çitaku - Dibrani</b> , <i>shefe e operatives në Stacionin e Policisë në Podujevë,</i>	anëtare
<b>Antoneta Ejupi</b> , <i>Drejtorja e Administratës,</i>	anëtare
<b>Avni Fetahu</b> , <i>Drejtorja e Arsimit,</i>	anëtar
<b>Leutrim Krasniqi</b> , <i>Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,</i>	anëtar
<b>Fatlum Osmani</b> , <i>Drejtorja e Buxhetit dhe Financave,</i>	anëtar
<b>Adelinë Stublla</b> , <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,</i>	anëtare
<b>Bajram Bajgora</b> , <i>Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare - Podujevë,</i>	anëtar
<b>Florentina Osmani</b> , <i>Drejtorja e Inspeksionit,</i>	anëtar
<b>Kujtim Zhitia</b> , <i>zyrtar për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,</i>	anëtar
<b>Ilaz Hoti</b> , <i>nga Shërbimi i Zjarrfikjes,</i>	anëtar
<b>Fatri Zhitija</b> , <i>Zëdhënës i Komunës,</i>	anëtar
<b>Makfiret Zeka</b> , <i>Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega Podujevë,</i>	anëtare

#### Neni 2

Shtabi Emergjent vepron në funksion të menaxhimit të situatës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera eventuale (reshje, vërshimeve, përmytjeve, zjarreve, tërmeteve, rrëshqitjeve të dheut e të tjera të ngjashme) në pajtim me ligjin dhe aktet tjera përkatëse të kësaj natyre si dhe koordinon ngushtë punët dhe aktivitetet me Agjencia e Menaxhimit Emergjent – AME

#### Neni 3

Për punët dhe angazhimet në terren, Shtabi informon Kryetarin e Komunës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/04-0027654/221 i datës 15.04.2022, dhe vendimet tjera pasuese për plotësim ndryshimet e këtij vendimi.

U dërgohet:  
Anëtarëve të Shtabit  
AME-së (për njoftim)  
QSHQ / Arkivit,

Nr.prot. 02-020/04-0006207/23  
Podujevë, datë: 20.01.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe nenin 19 parag.1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM

### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT LOKAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

#### Neni 1

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe të mirat tjera si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës së Podujevës, themelohet komisioni në përbërje;

Hamide Aliu,	kryesuese
Egzona Rama,	anëtare
Majlinda Gashi,	anëtare
Ardonis Jusufi,	anëtar
Afrim Mulliqi,	anëtar

#### Neni 2

Komisioni punët dhe detyrat i ushtron në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe aktet tjera përkatëse nënligjore në fuqi.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0001750/21, datë 11 janar 2021, për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

*U dërgohet;  
Të emëruarve  
QSHQ/Arkivës*

Nr. prot. 02-020/04-0006222/23  
Podujevë, datë: 23.04.2023





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **NËNKRYETARJA E KOMUNËS**

Bazuar në nenet 5 dhe 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

### **VENDIM PËR EMËRIMIN E ASISTENTES ADMINISTRATIV NË ZYRËN E NËNKRYETARES SË KOMUNËS**

#### **Neni 1**

**znj. Kaltrina Mustafa**, nga Podujeva, me kualifikim bachelor-drejtimi Infermieri, emërohet;

➤ **Asistente administrative në Zyrën e Nënkyetares së Komunës së Podujevës**

#### **Neni 2**

E përmendura në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative teknike të Nënkyetares së Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësiive.

Mandati i të emëruarës është në kohëzgjatje të mandatit të Nënkyetares së Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

#### **Neni 3**

Paga mujore e të emëruarës caktohet sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 4**


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset Zyra e Personelit.

*I dërgohet:*  
Të emëruarës  
Zyrës së personelit  
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/02-0007033/23  
Podujevë, datë: 25.01.2023



Nënkyetarja e Komunës  
**Mirigona Lahu**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 61 parag 1.2 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-0050862/18, në Ftesë për seancë të datës 24.01.2023 të Organit Shqyrtues të Prokurimit - OSHP për seancë, jep

### **A U T O R I Z I M**

Autorizohet z.Rasim Fejza, Menaxher i Zyrës së Prokurimit - Podujevë, të përfaqësojë Komunën e Podujevës në Organin Shqyrtues të Prokurimit-OSHP në seancën për shqyrtimin kryesor sipas ankesës nr. 726-728/22, e cila është caktuar të mbahet më 26.01.2023.

**Nr.prot.02-020/05-0007374/23**  
**Podujevë, datë: 26.01.2023**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**

*for* *Am*